V E N D I M
Nr.229, datë 21.8.2001

PËR SHPALLJEN E LISTËS SË DEPUTETËVE TË PARTISË ALEANCA DEMOKRATIKE, TË CILËT PËRFITOJNË NGA NDARJA E MANDATEVE PLOTËSUESE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN PËR VITIN 2001

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 21.8.2001, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Gasper Kokaj	Zëvendëskryetar
Pandeli Varfi	Anëtar
Tomor Malaj	Anëtar
Maksim Shimani	Anëtar
Igli Toska	Anëtar

MORI NË SHQYRTIM ÇËSHTJEN ME:

Objekt: Për shpalljen e listës së deputetëve të Partisë Aleanca Demokratike, të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001.

Baza ligjore: Neni 18 pika 4 e ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur:

KONSTATOI SE:

Partia Aleanca Demokratike, në zbatim të neneve 81, 82 e 83 të Kodit Zgjedhor, në datë 2.6.2001, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve listën shumemërore të kësaj partie. Kjo listë është shqyrtuar dhe miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.783, datë 2.6.2001 "Për rregjistrimin e listës shumemërore të Partisë Aleanca Demokratike, për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001".

Nga ndarja e mandateve plotësuese për deputetë të cilët i përkasin një partie apo koalicionit të partive, në bazë të përqindjes që Partia Aleanca Demokratike ka marrë në zgjedhjet për Kuvendin, llogaritet të marrë 3 deputetë nga numri i përgjithshëm i mandateve plotësuese. Në bazë të listës shumemërore të dorëzuar dhe të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfitojnë nga kjo listë të gjithë kandidatët me numër rendor nga 1 deri në 3.

PËR SA MË SIPËR:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 18 pika 4 të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë".

V E N D O S I:

1.Të shpallë listën e deputetëve të Partisë Aleanca Demokratike, të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001, si vijon:

1.z.Arben Imami
2.z.Neritan Ceka
3.z.Preç Zogaj.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Zëvendëskryetari	Kryetari
Gaspër Kokaj	Ilirjan Celibashi